

PËRMIRËSONI PRODUKTIVITETIN E ZYRËS SUAJ ME SKANIM TË BESUESHËM DHE KOMOD PËR TRYEZA

Skanerët Canon imageFORMULA të serisë DR-C300 janë skanerë dokumentesh A4 tejet kompaktë të projektuar për maksimizimin e efikasiteteve të proceseve të punës me dokumente në hapësira pune të vogla.


SHPEJTËSIA E SKANIMIT
DR-C360: 60 PPM/120 IPM
DR-C350: 50 PPM/100 IPM
DR-C340: 40 PPM/80 IPM

VETËMBUSHËSJA E DOKUMENTEVE
100 FLETË

**SKANIME TË SUGJERUARA
NË DITË**
DR-C360: DERI NË 13 000
DR-C350: DERI NË 8000
DR-C340: DERI NË 7000

PËRMASA KOMPakte
VETËM 283 MM I GJERË

 **imageFORMULA**
DR-C300 series



PËRFITIMET

- **Kurseni hapësirë në tavolinë** me dizajnin elegant të skanerit tonë; ideal për zyra degësh, hapësira tregtare dhe zona pritjeje.
- **Procese pune me dokumente praktike dhe fleksibël** me mekanizmin e fortë të mbushjes që garanton besueshmërinë optimale për skanimin e llojeve të ndryshme të dokumenteve.
- **Operim i thjeshtë** me një ekran intuitiv dhe ikona praktike, duke përfshirë skanimin me një prekje me punë të parakonfiguruar, që përshpejton dhe thjeshton punët e skanimit.
- **Maksimizoni produktivitetin** me shpejtësi skanimi dyanësh deri në 120 ipm dhe kapacitet për të stivosur deri në 100 fletë në mbushësen e dokumenteve.
- **Skanim me cilësi të lartë** falë mjeteve të ndryshme të përpunimit të përparuar të imazheve për të prodhuar automatikisht imazhe të qarta dhe të pastra nga të gjitha llojet e dokumenteve, edhe ato me shkrim të zbehtë ose sfonde me motive.
- **Softueri i përfshirë** që ofron vlerë të shtuar me emërtimin automatik të skedarëve, ndarjen në grupe dhe përpunimin OCR/të barkodeve dhe ruajtjen e skedarëve në formate të shumta.
- **Reduktioni ndikimin në mjedis** Mbështetni mjedisin duke përdorur këtë pajisje shumë të qëndrueshme me konsum të ulët të energjisë dhe përdorim të reduktuar të pjesëve.

ULTRA KOMPAKT ME FUNKSIONIM TË LEHTË DHE FLEKSIBËL.

ULTRA KOMPAKT DHE JU KURSEN HAPËSIRË

Krijuar për zyrat ku hapësira është e kufizuar, seria DR-C30 vjen me një dizajn ultra kompakt, që zë shumë më pak hapësirë në tavolinë sesa shumë modele konkurruese. Zgjedhja ideale për zyrë degësh, mjedise tregtare dhe zona pritjeje ku maksimizimi i hapësirës së punës është thelbësor.



MBËSHTETJE PRAKTIKE PËR TË GJITHA PROCESAT E PUNËS ME DOKUMENTE

Krijuar me një mekanizëm shumë të fortë të mbushjes, pajisjet e serisë DR-C300 skanojnë në grup në mënyrë të besueshme lloje të ndryshme dokumentesh nga letrat tejet të holla dhe kartat e identitetit të dokumentet deri në 6 m të gjata. Pasaportat mund të skanohen gjithashtu drejtpërdrejt nëpërmjet mbushës pa pasur nevojë të përdoret fletëmbajtëse e veçantë. Zbulimi ultrasonik i mbushjes së dyfishtë garanton skanimin e të gjitha dokumenteve dhe funksioni "Lëshimi i mbushjes së dyfishtë" (DFR) lejon rifillimin me shpejtësi të skanimit duke minimizuar ndërprerjet e punës.

OPERIM I THJESHTË PËR SKANIM PA TELASHE

Operim i thjeshtë me një ekran intuitiv dhe ikona praktike, duke përfshirë skanimin me një prekje me punë të parakonfiguruar, që përshpejton dhe thjeshton punët e skanimit. Butonat e ngritur mbështesin aksesueshmërinë, ndërsa sensorët sinjalizojnë gabimet për të vazhduar procesin e skanimit pa ndërprerje. Gjithashtu, me Mjetin e Menaxhimit DR, mund të menaxhoni në mënyrë qendrore disa skanerë në të gjithë organizatën tuaj. Skanerët ofrohen me kablllo Type-C™ për lidhje të lehtë dhe të thjeshtë.





MAKSIMIZONI PRODUKTIVITETIN DHE CILËSINË E IMAZHIT

Përmirësoni rendimentin dhe efikasitetin me skanimin e dyfishtë deri në 120 ipm (modeli DR-C360). Duke përdorur mbushësen e madhe me 100 fletë, skanoni disa dokumente njëherazi, kurseni më shumë kohë dhe përpjekje me ndarjen automatike të skedarëve dhe komandat e përshtatura të përpunimit të imazheve. Krijoni imazhe me cilësi të lartë të vazhdueshme duke skanuar të gjitha llojet e dokumenteve falë Active Threshold dhe mjeteve të tjera të përparuara të përpunimit të imazheve.



SOFTUERI I FUQISHËM ME OCR

CaptureOnTouch Pro është një softuer skanimi për kompjutera, i fokusuar te klienti, që ofron një ndërfaqe të lehtë për përdoruesin përmes operimit të thjeshtë me anë të ikonave, si dhe mjete të fuqishme për përpunimin e dokumenteve. Konfiguron punë për ruajtje në formate të ndryshme, duke përfshirë PNG, JPEG, TIFF, BMP, PPTX, Word dhe Excel, mbështet njohjen optike të karaktereve (OCR), barkodeve dhe kodeve 2D, si dhe gjeneron skedarë indeksesh të dhënash për integrim të lehtë në proceset ekzistuese të punës dhe sistemet e menaxhimit të dokumenteve.

KURSENI KOSTOT E PËRDORIMIT

Përdorni Mjetin e Menaxhimit të Skanerit DR nga Canon për të monitoruar njëkohësisht dhe shpërndarë cilësimet për një numër të madh skanerësh në të gjithë biznesin tuaj dhe mjediset e përdoruesve.

REDUKTONI NDIKIMIN NË MJEDIS

Përdorimi i kompletit të ruleve zëvendësuese për rimbushje ndihmon në minimizimin e mbetjeve, ndërsa paketimi prej materialesh të ripërdorshme dhe të biodegradueshme ndihmon në uljen e konsumit të plastikës. Modelet e serisë DR-C300 kanë konsum të ulët energjie dhe kursejnë burime falë numrit optimal të pjesëve të përdorura.





SPECIFIKIMET E PRODUKTIT			
	DR-C340	DR-C350	DR-C360
Lloji	Skaner me mbushje fletësh dyanëshe, tipi për tryezë		
Njësia e sensorit të skanimit	CIS		
Rezolucioni optik	600dpi		
Burimi i dritës	LED RGB		
Ana e skanimit	Para/Prapa/Në të dyja anët		
Ndërfaqe të mbështetura	USB 3.2 / USB 3.1 / USB 3.0 / USB 2.0 (Lloji i konektorit: Type -C™) ¹		
Përmasat (Gjer.xThell.xLart.)	Sirtari i mbyllur: 283 x 223 x 218 mm		
Pesha	3,2 kg		
Nevojat për energji	AC 220 - 240 V (50/60 Hz)		
Konsumi i energjisë	Skanim: 15,6 W ose më pak Modaliteti pasiv: 0,6 W I fikur: 0,1 W ose më pak		
Mjedisi i përdorimit	Temperatura: 10°C - 32,5°C Lagështia: 20% deri në 80% lagështi relative (RH)		
Pajtueshmëria mjedisore	Produkti: EPEAT ² , Energy STAR ³ , RoHS Prodhuesi: ISO 9001, ISO 14001, ISO 45001, ISO 13485		
SPECIFIKIMET E SKANIMIT			
Bardhezi (A4, 200 dpi)	40 ppm/80 ipm	50 ppm/100 ipm	60 ppm/120 ipm
Me ngjyra (A4, 200 dpi)	40 ppm/80 ipm	50 ppm/100 ipm	60 ppm/120 ipm
Rezolucioni në dalje	100/150/200/240/300/400/600/1200 dpi		
Modaliteti në dalje	Me ngjyra/Nuancat e grisë/Bardhezi		
Volumi i këshilluar ditor	nga 4500 në 7000 skanime/ditë	nga 5000 në 8000 skanime/ditë	nga 7500 në 13 000 skanime/ditë
SPECIFIKIMET PËR DOKUMENTET			
Gjerësia	50 - 216 mm		
Gjatësia	54 - 356 mm		
Trashësia	27 g/m ² - 413 g/m ² (0,04 - 0,49 mm)		
Modaliteti i dokumenteve të gjata	Deri në 6096 mm		
Skanimi i kartëvizitave	Gjerësi: 50 - 55 mm / Gjatësi: 85 - 91 mm / Trashësi: 128 - 255 g/m ² (0,15 - 0,3 mm)		
Skanimi i kartave plastike	Gjerësi: 86 mm / Gjatësi: 54 mm / Trashësi: 1,4 mm ose më pak (Mbështeten kartat me relief)		
Skanimi i pasaportave	Trashësi deri në 6,0 mm (me fletëmbajtëse)/4,0 mm (pa fletëmbajtëse)		
Ndarja e letrës	Metoda me rul ngadalësues		
Kapaciteti i mbushës	100 fletë (A4)		

VEÇORITË E VEÇANTA	
	Seria DR-C
Veçoritë e veçanta	Zbulim ultrasonik i mbushjes së dyfishtë, zbulim automatik i ngjyrave, anashkalim i faqeve bosh, zbulim automatik i përmasave të faqes, cilësim automatik i rezolucionit, zbulim i orientimit të tekstit, njohje e barkodit/kodit 2D, njohje OCR, ndarje në grupe, prag aktiv, përmirësim i tekstit (I/I), drejtimi, lëshim i mbushjes së dyfishtë, skanim paraprak, korrigjim 3-dimensional i ngjyrave, parandalim i tejkalimit të kontureve/heqje e sfondit, zbutje e sfondit, theksim i karaktereve, heqje/përmirësim i ngjyrave (RGB), funksioni MultiStream, cilësime të rregullueshme të veçorisë gamma, reduktim i Moire, modaliteti me format të madh, rregullim i raportit të reduktimit, kontrast bardhezi, imazh i kundërt, sistem i rikthimit të shpejtë.
SOFTUERËT E PËRFSHIRË	
Windows	Drajverë ISIS, TWAIN dhe WIA / CaptureOnTouch Pro / Mjeti i parametrit të softuerit drejtues Canon imageFORMULA / Mjeti i menaxhimit DR (vetëm me shkarkim)
OPSIONE TË TJERA	
Pjesët e konsumit	Kompleti i ruleve zëvendësuese
Opsionet	Njësia e skanerit me shtrat të sheshtë 102 (A4) Fletëmbajtëse A4 Fletëmbajtëse pasaporte

Të gjitha të dhënat bazohen në metodat standarde të testimit nga Canon përveç ku tregohet ndryshe.

Mund të ndryshojë pa njoftim paraprak.

Shënimet e fundfaqes:

¹ USB Type-C™ dhe USB-C™ janë marka tregtare të USB Implementers Forum.

² EPEAT është certifikim në SHBA

³ ENERGY STAR nuk është i zbatueshëm në Evropë

Mohimi i përgjegjësisë

Të gjitha të dhënat bazohen në metodat standarde të testimit nga Canon përveç ku tregohet ndryshe. Shpejtësia e skanimit mund të ndryshojë në varësi të mjedisit kompjuterik, cilësimeve të skanerit dhe faktorëve të tjerë. Ka kufizime në veçoritë në dispozicion sipas softuerit, drajverit dhe sistemit operativ të përdorur. Specifikimet mund të ndryshojnë pa njoftim paraprak. Vizitoni faqen e internetit të Canon për më shumë informacion. Canon dhe logoja e Canon janë marka tregtare ose marka të regjistruara të Canon Inc. në Shtetet e Bashkuara dhe mund të jenë gjithashtu marka tregtare ose marka tregtare të regjistruara në shtete të tjera.

imageFORMULA është një markë tregtare e CANON ELECTRONICS INC.

Microsoft, Windows, Microsoft Edge, dhe Microsoft Teams janë marka tregtare të regjistruara ose marka tregtare të Microsoft Corporation në Shtetet e Bashkuara dhe në shtete të tjera.

QR Code është një markë tregtare e regjistruar e DENSO WAVE INCORPORATED në Japoni dhe në shtete të tjera.

ISIS është një markë tregtare e regjistruar e OpenText në Shtetet e Bashkuara.

Canon Electronics Inc.
canon-elec.co.jp

Canon Europe
canon-europe.com

Albanian edition

© Canon Europa N.V., 2026